



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 26.07.2024

Nr. 2209 prot

Data: 26.7.2024

Nr: 132

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

“PËR CAKTIMIN E VENDNDODHJES SË NJË QENDRE VOTIMI NË NDËRTESË PRIVATE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024”

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Caktimin e vendndodhjes së Qendrës së Votimit nr. 4562/00 në ndërtesë private, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 26.7.2024

Nr: 132
Ora: 12:00



“Për caktimin e vendndodhjes së një qendre votimi në ndërtesë private për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”

Lidhja nr. 1

Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Administrative	QV	Sipërfaqja	Vendndodhja
Vlorë	Himarë	1.	Lukovë	4562/00	60m2	Fshati “Shën Vasil” numër 52, lokali i zj. Elsa Hysen Xhako